



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:170987

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05713752

**K.Dh.shk.II.nr.353/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS E KOSOVËS**, Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtari individual Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Klan Kosova” Sh.p.k, me NUI;810795297 me seli në Prishtinë, Zona Industriale ish Fabrika e Amortizatorëve, kundër debitorit “United Hospital” L.L.C me NUI:811551599 me seli në Llapllasellë p.n Graçanicë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Florim Shefqeti avokat nga Prishtina, lidhur me çështjen përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti i Për Çështje Ekonomik, KPPP.nr.1257/23, të datës 20.10.2023, me datën 20.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kreditorit “Klan Kosova” Sh.p.k, me NUI;810795297 me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti i Për Çështje Ekonomik, KPPP.nr.1257/23, të datës 20.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti i Për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1257/23, të datës 20.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar propësimin e debitorit “United Hospital” L.L.C me NUI:811551599 me seli në Llapllasellë, dhe ka shuqizuar urdhërin përmbarimor P.nr.1137/23, i datës 18.07.2023, i lëshuar nga Zyra përmbarimore e Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kreditori ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, ndërsa aktvendimin e ankimuar t’ a prishë dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit debitori edhe pse të njejtën e ka pranuar me datën 09.01.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Klan Kosova” Sh.p.k, me NUI;810795297 me seli në Prishtinë me datë 17.07.2023, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “United Hospital” L.L.C me NUI:811551599 me seli në Llapllasellë, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës nr.032223002-7 e datës 22.03.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që ti paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 20,000.00€.

Përmbaruesi Privat Isa Gacaferri me urdhërin përmbarimor P.nr.1137/23, i datës 18.07.2023, e ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur propësim duke theksuar se me kreditorin ka pasur bashkëpunim të shkëlqyer së bashku, të njejtit kishin lidhur marrëveshje bashkëpunimi për hapësira reklamuese. Ka shtuar se fatura e cila i është bashkangjitur propozimit është e pa vulosur

nga debitori, kjo për shkak të mosrespektimit të kontratës nga ana e kreditorit, mbi bazën e kësaj kreditori ka për qëllim përfitimin e kundërligjshëm duke e dëmtuar debitorin e po ashtu duke ju shmangur obligimeve tatimore që dalin nga marrëveshja, po ashtu ka cek se kontrata nuk paraqet titull përmbarimor, dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitori dhe urdhërin përmbarimor të shfuqizoj.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësimi dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si e pa bazuar, duke cek se fatura në bazë të së cilës është inicuar procedura përmbarimore i përmbushë të gjitha elementet në përputhje me nenin 29 par 3 të LPP-së.

Dhomat e Shkallës së Parë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, pas shqyrtimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1257/23, të datës 20.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit P.nr.1137/23, i datës 18.07.2023 të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat. Me arsyetim se fatura me nr.032223002 e datës 22.03.2023 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit-debitorit nuk ka dëshmi se e njejta është pranuar nga debitori.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdest dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dyte vlerëson se dhoma e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim duke vlerësuar se

Faturës nr.032223002-7 e datës 22.03.2023 nuk i plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar dhe nënshkruara nga debitori. Sipas dispozitës së nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, andaj në rastin konkret gjykata vlerëson se nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyrimi nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturës.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturave nga ana e debitorit ngase faturën e ka dërguar me e-mail. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura fatura duhet të jenë të nënshkruar, po ashtu nga shkresa elektronik nuk figuron se debitori ka konfirmuar pranimin e faturës, andaj një pretendim e tillë u refuzua si e pa bazuar, po ashtu kjo gjykatë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore por i refuzoj si të pa bazuar pasi që nuk kishin ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbnimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Shk.II.nr.353/24, me datën 20.05.2024

Gj y q t a r j a,  
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2023:170987  
Datë: 21.05.2024  
Numri i dokumentit: 05713752